



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 24, datë 14.01.2020

PËR

KOMANDIMIN E GJYQTARES Znj{...} NË POZICIONIN E NËPUNËSIT PËRGJEGJËS PËR VLERËSIMIN NË NJËSINË E VLERËSIMIT PROFESIONAL DHE ETIK TË GJYQTARËVE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 53, 54 pika 5 dhe 6 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 104, datë. 05.07.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtareve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

V E N D O S I:

1. Komandimin e gjyqtares Znj{...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.
2. Periudha e komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon në datë 02.03.2020.
3. Përrjashtimin e menjëhershëm të gjyqtares Znj{...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore me short në gjykatë, me përjashtim të “çështjeve urgjente”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR